

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 34/2019 “Per administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Punëve të Brendshme
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	19/12/2025 21/01/2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	25/06/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po/Jo 03/03/2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MPB – Nr. 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Jasmina Daiu Jasmina.daiu@aapsk.gov.al 0698169679 Santeliana Meta Santeliana.meta@mb.gov.al 0692084033

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Ligji nr. 34/2019 “Per administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar me Ligjin nr. 19/2020.

Ndryshimet me ligjin nr. 19/2020, janë bërë ndër të tjera për dy arsye kryesore:

- Kanë ndryshuar varësinë e institucionit nga Ministria përgjegjëse për financat, në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike
- Është shtuar si organ kompetent për vendimarrje të rëndësishme Komiteti Ndërinstitucional për masat kundër Krimit të Oranizuar.
- Gjithashtu ky ligj ka shfuqizuar :
 1. VKM nr. 782, datë 16.10.2019“Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK)”

2. VKM nr. 781, datë 16.10.2019 “Për rregullat dhe procedurat e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”

3. VKM nr. 780, datë 16.10.2019 “Për procedurat e shitjes së pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”

4. VKM nr. 777, datë 16.10.2019 “Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar”

5. VKM nr. 778, datë 16.10.2019 “Për përdorimin social të pasurive të konfiskuara”

6. VKM nr. 779, datë 16.10.2019 “Për mënyrën e administrimit të të ardhurave nga pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara”

Ndërkohë që, me ndryshimet e reja, aktet nënligjore në funksion të ligjit, janë si vijon:

- VKM Nr. 835, datë 28.10.2020 “Për rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”
- VKM Nr. 888, datë 11.11.2020 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”
- Udhëzim Nr. 374, datë 18.11.2020, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për financimin e projekteve nga Fondi i Posaçëm Për Parandalimin e Kriminalitetit
- Udhëzim Nr. 55, datë 27.4.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të shitjes dhe depozitimit të të ardhurave nga shitja e pasurive të sekuestruara, të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit”
- Udhëzim nr. 324, datë 02.10.2020 ‘Për përcaktimin e rregullave, procedurave për administrimin e të ardhurave dhe limiteve të kryerjes së shpenzimeve për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara”

Kuadri ligjor aktual për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, edhe pas ndryshimeve të vitit 2026, paraqet boshllëqe të rëndësishme, veçanërisht në drejtim të përfshirjes së plotë të të gjitha kategorive të pasurive që burojnë nga vendimmarrja e organeve të ndryshme publike.

Në formën aktuale, kuadri ligjor fokusohet kryesisht në pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet e drejtësisë, duke lënë jashtë një gamë të konsiderueshme pasurish që burojnë nga veprimtaria e organeve administrative, njësisive të vetëqeverisjes vendore apo institucioneve të tjera publike.

Në praktikë, kjo ka sjellë një trajtim ligjor të kuadratur dhe institucional të këtyre pasurive, duke krijuar paqartësi në përgjegjësitë administrative, procedurat e administrimit dhe përdorimin përfundimtar të tyre. Në veçanti, pasuritë e konfiskuara si rezultat i ndërtimeve pa leje apo vendimeve administrative nuk janë trajtuar në mënyrë të unifikuar, gjë e cila ka ndikuar negativisht në menaxhimin efikas dhe në mundësinë e rikthimit të tyre në funksion të interesit publik.

Një tjetër procedurë e rëndësishme lidhet me zhvillimet e fundit ekonomike dhe teknologjike, të cilat kanë sjellë forma të reja pasurish, si monedhat virtuale (kriptomonedhat). Kuadri ligjor aktual nuk ofron rregullim të plotë për administrimin, ruajtjen dhe likuidimin e këtyre pasurive, duke krijuar boshllëqe praktike dhe rrezik për humbje vlere apo keqadministrim.

Gjithashtu, rritja e vazhdueshme e numrit të vendimeve për sekuestrim dhe konfiskim ka shtuar presionin mbi kapacitetet institucionale ekzistuese, duke evidentuar nevojën për mekanizma më të qartë dhe më efikasë për administrimin, përfshirë krijimin e fondeve të dedikuara dhe procedurave të standardizuara për kategori të veçanta pasurish.

Si pasojë e këtyre mangësive, evidentohen vështirësi konkrete në mirëadministrimin, përdorimin efikas dhe ekonomik të pasurive, si dhe në rikthimin e tyre në dobi të komunitetit, përfshirë përdorimin për qëllime sociale, publike apo kompensimin e viktimave të krimit.

Problematikat kryesore:

a) Fushë e kufizuar e zbatimit të ligjit ekzistues

Ligji aktual nuk përfshin në mënyrë të plotë administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet administrative dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Pasoja:

- boshllëk ligjor në administrimin e këtyre pasurive;
- mungesë standardizimi në procedura;
- trajtim i fragmentuar institucional;
- risk për mosadministrim efikas.

b) Mungesë rregullimi për kategori specifike pasurish (ndërtimet pa leje)

Aktualisht mungojnë mekanizma të dedikuar për administrimin financiar dhe përdorimin e pasurive që burojnë nga konfiskimi i ndërtimeve pa leje.

Pasoja:

- paqartësi mbi destinacionin e fondeve;
- përdorim jo optimal i këtyre aseteve;
- vështirësi në rikthimin e tyre në funksion publik.

c) Mungesë kuadri për administrimin e monedhave virtuale

Legjislacioni aktual nuk parashikon rregulla të posaçme për administrimin, ruajtjen, transferimin dhe likuidimin e kriptomonedhave të sekuestruara ose të konfiskuara.

Pasoja:

- risk i humbjes së vlerës ekonomike;
- pasiguri juridike;
- ekspozim ndaj keqadministrimit ose humbjes teknologjike.

d) Procedura jo të plota për administrimin ekonomik të pasurive

Kuadri aktual nuk siguron mekanizma të mjaftueshëm për përdorim efikas ekonomik të pasurive.

Pasoja:

- vonesa në administrim;
- ulje e vlerës së aseteve;
- kosto shtesë administrative.

e) Presion mbi kapacitetet institucionale të AAPSK

Rritja e volumit dhe kompleksitetit të pasurive ka tejkaluar pjesërisht mekanizmat ekzistues.

Pasoja:

- mbingarkesë administrative;
- ulje e eficiencës operacionale;
- nevojë për procedura të reja standardizuese.

2. Shkaqet e problematikave

Shkaqe ligjore

- Ligji nr. 34/2019 është hartuar kryesisht për pasuritë që burojnë nga procedurat penale.
- Mungesë parashikimi për format e reja të pasurisë.
- Mosreflektim i evoluimit të praktikës administrative.

Shkaqe institucionale

- Kompetenca jo plotësisht të qarta ndërmjet institucioneve.
- Mungesë koordinimi ndër-institucional.
- Procedura të paunifikuara.

Shkaqe teknologjike

- Shfaqja e kriptoaseteve si kategori e re pasurore.
- Mungesë infrastrukture teknike për administrimin e tyre.

Shkaqe praktike-operacionale

- Rritje e numrit të vendimeve për sekuestrim/konfiskim.
- Diversifikim i natyrës së pasurive.
- Nevoja për modele më fleksibël administrimi.

3. Grupet e prekura

a) Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK)

Si preket:

- merr kompetenca të reja;
- shtohen përgjegjësitë administrative;
- kërkohet përshtatje organizative dhe teknike;
- nevojë për kapacitete shtesë.

b) Organet administrative dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore

Si preken:

- qartësohen procedurat e transferimit të pasurive;
- standardizohet bashkëpunimi institucional;
- shtohen detyrimet procedurale.

c) Organet e drejtësisë (gjykata, prokurori)

Si preken:

- përmirësohet koordinimi me AAPSK;
- krijohet bazë më e qartë për administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara.

d) Subjektet ndaj të cilëve janë marrë masa sekuestrimi/konfiskimi

Si preken:

- rritet qartësia procedurale;
- forcohet siguria juridike mbi administrimin e pasurive.

e) Komuniteti / publiku

Si preket:

- rritet mundësia e përdorimit të pasurive për interes publik;
- përfitime potenciale sociale dhe komunitare;
- rritet efica ncia në rikthimin e aseteve në funksion publik.

f) Viktimat e krimit

Si preken:

- krijohen mundësi më të mira për kompensim financiar përmes administrimit më efikas të pasurive.

g) Operatorët ekonomikë / tregu

Veçanërisht në rastet e shitjes, qirasë, huapërdorjes apo en fiteozës.

Si preken:

- krijohen më shumë mundësi pjesëmarrjeje;
- procedura më të qarta kontraktore.

Për këto arsye, ndërhyrja e qeverisë është e domosdoshme dhe synon:

- zgjerimin e fushës së zbatimit të ligjit për të përfshirë në mënyrë eksplicite pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet administrative dhe pushteti vendor;
- adresimin e kategorive specifike të pasurive, si ndërtime pa leje, përmes mekanizmave të dedikuara financiarë dhe administrativë;
- përcaktimin e rregullave për administrimin e formave të reja të pasurisë, përfshirë monedhat virtuale;
- forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e efikasitetit në përdorimin dhe rikthimin e pasurive në interes të publikut.

Kjo nismë, mund të lidhet me dokumente të rëndësishme politike të qeverisë si për shembull:

1. Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024–2030

Nisma lidhet me këtë strategji pasi:

- synon rritjen e efikasitetit institucional (AAPSK dhe institucionet e tjera);
- përmirëson proceset administrative dhe standardizimin e tyre;
- forcon kapacitetet menaxhuese të administratës publike.

2. Reforma në drejtësi dhe forcimi i shtetit të së drejtës

Projektligji është pjesë e kuadrit më të gjerë të reformës në drejtësi, duke:

- mbështetur zbatimin efektiv të vendimeve gjyqësore për sekuestrim dhe konfiskim;
- rritur eficiencën e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave dhe prokurorisë;
- forcuar administrimin e pasurive që burojnë nga veprimtari kriminale.

3. Strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Nisma lidhet ngushtë me këtë strategji pasi:

- përmirëson menaxhimin e pasurive të konfiskuara nga veprimtari kriminale;
- rrit transparencën dhe gjurmueshmërinë e aseteve të sekuestruara;
- mbështet rikthimin e aseteve në interes publik.

4. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)

Nisma kontribuon në objektivat e integritetit evropian duke:

- përafruar kuadrin ligjor me standardet e BE-së në fushën e menaxhimit të aseteve;
- forcuar kapacitetet institucionale në administrimin e pasurive publike;
- rritur besueshmërinë e sistemit të drejtësisë ekonomike.

5. Kuadri për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT)

Nisma lidhet gjithashtu me:

- përmirësimin e administrimit të pasurive të sekuestruara nga veprimtari të dyshuara kriminale;
- rritjen e efektivitetit të masave të konfiskimit;
- përfshirjen e kryptoaseteve në kuadrin e kontrollit financiar.

Arsyet e ndërhyrjes së qeverisë dhe çfarë synon të trajtojë nisma

Ndërhyrja e qeverisë në këtë nismë ligjore është e domosdoshme për të adresuar boshllëqet ekzistuese në kuadrin ligjor dhe institucional për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe për të përshtatur legjislacionin me zhvillimet e fundit ekonomike, teknologjike dhe praktikave administrative.

Në mënyrë specifike, nisma synon të trajtojë këto çështje kryesore:

1. Zgjerimin e fushës së zbatimit të ligjit

Qeveria synon të përfshijë në mënyrë eksplicite edhe pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet administrative dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke eliminuar fragmentimin aktual të kuadrit ligjor dhe duke siguruar një trajtim të unifikuar institucional.

2. Unifikimin dhe qartësimin e procedurave të administrimit

Nisma synon të vendosë rregulla të qarta dhe të standardizuara për administrimin, shitjen, qiranë dhe përdorimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, duke përmirësuar efikasitetin dhe transparencën në proces.

3. Trajtimin e kategorive specifike të pasurive (ndërtimet pa leje)

Një ndër qëllimet kryesore është krijimi i mekanizmave të dedikuar financiarë dhe administrativë për pasuritë që burojnë nga ndërtimet pa leje, përmes krijimit të një fondi të posaçëm, me synim përdorimin e tyre në funksion të interesit publik.

4. Rregullimin e administrimit të pasurive të reja (monedhat virtuale)

Nisma synon të adresojë boshllëkun ekzistues për kryptoasetet, duke përcaktuar rregulla për administrimin e monedhave virtuale të sekuestruara apo të konfiskuara, si dhe duke mundësuar ruajtjen dhe menaxhimin e tyre në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar.

5. Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e efikasitetit

Nisma synon të përmirësojë kapacitetet e AAPSK dhe të rrisë efikasitetin në administrimin e pasurive, duke përballuar rritjen e numrit dhe kompleksitetit të rasteve.

6. Rritjen e përdorimit të pasurive në interes publik

Qëllim i rëndësishëm është rikthimi më efektiv i pasurive të konfiskuara në dobi të komunitetit, përmes përdorimit të tyre për qëllime sociale, publike dhe për kompensimin e viktimave të krimit.

Puna ekzistuese e kryer deri më tani

Deri në këtë fazë, administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara është realizuar në bazë të kuadrit ligjor ekzistues dhe praktikave administrative në fuqi. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) ka ushtruar funksionet e saj ligjore për identifikimin, marrjen në administrim, ruajtjen, mirëmbajtjen, administrimin ekonomik dhe disponimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Gjatë kësaj periudhe janë zbatuar procedurat standarde për shitjen, dhënien me qira, transferimin dhe administrimin e pasurive, duke synuar ruajtjen e vlerës ekonomike të tyre dhe minimizimin e kostove që lidhen me mirëmbajtjen. Njëkohësisht, është zhvilluar bashkëpunim i vazhdueshëm ndërinstytucional me organet e sistemit të drejtësisë, veçanërisht me prokuroritë dhe gjykatat, për ekzekutimin e vendimeve të sekuestrimit dhe konfiskimit, si dhe për garantimin e administrimit të rregullt të pasurive gjatë gjithë ciklit të procedurave ligjore.

Për menaxhimin e pasurive të konfiskuara janë përdorur praktikat administrative ekzistuese, duke siguruar ruajtjen, inventarizimin dhe monitorimin e tyre deri në momentin e shitjes, transferimit ose përdorimit në interes publik. Gjithashtu, në raste të caktuara është realizuar koordinim me njësitë e pushtetit vendor dhe institucione të tjera publike, veçanërisht kur pasuritë kanë pasur ndikim në komunitetet lokale ose janë konsideruar të përshtatshme për ripërdorim në funksion të interesit publik.

Vlen të theksohet se, veçanërisht që nga fundi i vitit 2024 dhe gjatë vitit 2025, është konstatuar një rritje e ndjeshme e volumit të pasurive të administruara, e vlerës ekonomike të tyre, si dhe e përdorimit të instrumenteve të ripërdorimit social dhe institucional. Ky zhvillim tregon një rritje të kapaciteteve operacionale të AAPSK-së dhe një rol gjithnjë e më aktiv të saj në garantimin e administrimit efektiv të pasurive me origjinë nga veprimtari kriminale.

Deri në dhjetor 2025, janë administruar në total 2,890 pasuri me një vlerë të përgjithshme prej rreth 19.97 miliardë lekësh, nga të cilat 1,679 pasuri të sekuestruara, 546 pasuri të konfiskuara dhe 665 prova materiale. Vetëm gjatë vitit 2025 janë administruar 1,211 pasuri me vlerë rreth 6.2 miliardë lekë, duke reflektuar një intensifikim të ndjeshëm të aktivitetit të agjencisë krahasuar me periudhat e mëparshme. Rezultatet e arritura kanë prodhuar gjithashtu ndikime të prekshme financiare për sektorin publik. Nga administrimi i pasurive janë gjeneruar rreth 3 milionë euro të ardhura nga qiratë, ndërsa mbi 16.8 milionë euro dhe 301 milionë lekë janë transferuar në mbështetje të buxhetit të shtetit dhe institucioneve ligjzbatuese. Këto të dhëna dëshmojnë se administrimi aktiv i pasurive jo vetëm që kontribuon në ruajtjen e vlerës së tyre, por edhe në krijimin e të ardhurave dhe burimeve shtesë për financat publike.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i punës së kryer lidhet me ripërdorimin e pasurive në interes publik. Deri në fund të vitit 2025 janë transferuar 4 pasuri të paluajtshme dhe 48 automjete në pronësi të institucioneve publike, ndërsa 2 pasuri të paluajtshme janë vënë në dispozicion të organizatave të shoqërisë civile për qëllime sociale. Gjithashtu, 38 automjete janë dhënë me kontratë qiraje dhe 12 automjete janë vënë në përdorim pa pagesë për institucione publike. Përmes këtyre mekanizmave janë mbështetur mbi 20 institucione publike dhe janë realizuar mbi 15 projekte me impakt social, duke demonstruar potencialin e pasurive të konfiskuara për të gjeneruar përfitime konkrete për komunitetin dhe për të kontribuar në forcimin e interesit publik.

Në tërësi, puna e realizuar deri më tani ka krijuar një bazë të rëndësishme administrative dhe institucionale për menaxhimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Megjithatë, rritja e vazhdueshme e numrit dhe kompleksitetit të pasurive nën administrim ka evidentuar nevojën për përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor dhe institucional, me qëllim rritjen e efikasitetit, transparencës dhe efektivitetit të procesit të administrimit dhe ripërdorimit të tyre.

OBJEKTIVAT

Objektivi i këtij projektligji është përmirësimi dhe zgjerimi i kuadrit ligjor për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, me synim garantimin e një mirëadministrimi sa më efikas, efektiv dhe ekonomik të tyre, pavarësisht nga organi që ka vendosur sekuestrimin apo konfiskimin.

Nisma synon në mënyrë të veçantë:

1. Sigurimi i përfshirjes së plotë në fushën e zbatimit të ligjit, brenda vitit 2027, të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet administrative dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke garantuar unifikimin e trajtimit ligjor të tyre.
2. • Sigurimi i rregullimit të plotë të administrimit të monedhave virtuale (kriptomonedhave), brenda vitit 2027, përmes përcaktimit të procedurave dhe rregullave të qarta për sekuestrimin, ruajtjen dhe administrimin e tyre.
3. • Sigurimi i krijimit dhe funksionimit të mekanizmave të posaçëm financiarë, brenda vitit 2027, për menaxhimin e pasurive të konfiskuara nga ndërtimet pa leje, në funksion të përdorimit të tyre për qëllime publike.
4. • Sigurimi i forcimit të kapaciteteve institucionale të strukturave përgjegjëse për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, brenda vitit 2027, përmes përmirësimit të proceseve, burimeve dhe standardizimit të procedurave.
5. • Sigurimi i rikthimit efektiv në komunitet të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme, brenda vitit 2027, përmes përdorimit të tyre për qëllime publike dhe sociale, si dhe mbështetjes së mekanizmave të kompensimit të viktimave të krimit.

Në aspektin procedural, projektligji synon gjithashtu optimizimin e proceseve të administrimit dhe shitjes së pasurive të konfiskuara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), duke reduktuar afatet dhe duke rritur efikasitetin e procedurave.

Kjo pritet të sjellë rritje të të ardhurave si për agjencinë, ashtu edhe për buxhetin e shtetit dhe fondet e posaçme, të cilat kontribuojnë në financimin e shërbimeve sociale dhe institucionale.

OPSIONET E POLITIKAVE

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së:

Ky opsion konsiston në vijimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe institucional ekzistues pa ndërmarrë ndryshime ligjore, organizative apo procedurale. Në këtë rast, administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara do të vazhdonte të realizohej në bazë të dispozitave aktuale të Ligjit nr. 34/2019 dhe akteve nënligjore në fuqi, duke ruajtur strukturat, procedurat dhe mekanizmat ekzistues të administrimit. Ky opsion shërben si skenari bazë kundrejt të cilit vlerësohen alternativat e tjera të ndërhyrjes.

Avantazhet

Avantazhi kryesor i këtij opsioni është se nuk kërkon angazhimin e burimeve shtesë financiare, administrative apo njerëzore për hartimin dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore ose institucionale. Institucionet do të vazhdonin të operonin sipas procedurave dhe praktikave tashmë të konsoliduara, pa pasur nevojë për trajnime shtesë, përshtatje organizative apo miratim të akteve të reja. Gjithashtu,

shmangen kostot dhe koha që lidhen me procesin e hartimit, konsultimit dhe miratimit të ndryshimeve ligjore.

Disavantazhet

Megjithatë, ruajtja e status quo-së nuk adreson problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të kuadrit aktual ligjor. Boshllëqet dhe paqartësitë ekzistuese do të vazhdonin të ndikojnë në efikasitetin e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, duke kufizuar mundësitë për optimizimin e përdorimit dhe disponimit të tyre. Gjithashtu, kuadri aktual nuk ofron zgjidhje të mjaftueshme për trajtimin e kategorive të reja të pasurive, si asetet digjitale dhe monedhat virtuale, të cilat po marrin një rëndësi gjithnjë e më të madhe në procedurat e hetimit dhe konfiskimit. Si rezultat, ky opsion rrezikon të thellojë vështirësitë praktike ekzistuese dhe të kufizojë aftësinë e institucioneve për t'iu përgjigjur zhvillimeve të reja në fushën e kriminalitetit ekonomik dhe financiar.

Opsioni 1 – Ndryshimi i ligjit ekzistues (ligji nr. 34/2019):

Ky opsion konsiston në ndërhyrjen në kuadrin ligjor ekzistues përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 34/2019, me qëllim adresimin e problematikave të identifikuara gjatë zbatimit të tij. Ndryshimet do të synojnë përmirësimin e dispozitave që lidhen me administrimin, ruajtjen, disponimin dhe ripërdorimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe qartësimin e kompetencave dhe përgjegjësisë të institucioneve të përfshira në këtë proces.

Në kuadër të këtij opsioni mund të parashikohen rregullime të dispozitave ekzistuese për të eliminuar paqartësitë ligjore dhe vështirësitë praktike të evidentuara gjatë zbatimit të ligjit, forcimi i mekanizmave të koordinimit ndërinstytucional, përmirësimi i procedurave të administrimit dhe disponimit të pasurive, si dhe zgjerimi i mundësive për përdorimin e tyre në interes publik. Gjithashtu, mund të përfshihen dispozita të reja që synojnë rritjen e efikasitetit të administrimit të pasurive dhe harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare në këtë fushë.

Ky opsion ruan strukturën bazë të kuadrit ligjor ekzistues dhe ndërhyrjet në ato dispozita që kanë rezultuar problematike ose të pamjaftueshme në praktikë, duke synuar arritjen e përmirësimeve të nevojshme pa qenë e nevojshme hartimi i një ligji tërësisht të ri.

Avantazhet

- Adresim i menjëhershëm i boshllëqeve ligjore ekzistuese, duke mundësuar përfshirjen e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet administrative dhe vendore pa nevojën e një riformatimi të plotë të kuadrit ligjor.
- Kosto më të ulëta implementimi, pasi ndërhyrja bazohet në një ligj ekzistues dhe nuk kërkon ngritjen e një strukture të re ligjore apo institucionale nga e para.
- Zbatim më i shpejtë në praktikë, duke qenë se institucionet zbatuese janë tashmë të njohura me ligjin ekzistues dhe procedurat bazë të administrimit të pasurive.
- Ruajtja e vazhdimësisë institucionale dhe administrative, duke shmangur ndërprerjet që mund të vijnë nga një reformë e thellë ligjore.
- Përshtatje graduale me zhvillimet e reja, siç janë monedhat virtuale dhe krijimi i fondeve të posaçme, duke lejuar integrim të kontrolluar në sistemin ekzistues.

Disavantazhet

- Zgjidhje e pjesshme e problematikave ekzistuese, pasi ndërhyrja kufizohet në amendime dhe nuk rishikon në mënyrë tërësore arkitekturën e ligjit, duke lënë disa boshllëqe strukturore të pazgjidhura.
- Mbetje e kompleksitetit dhe fragmentimit normativ, sidomos për shkak të ndërhyrjeve të shumta në ligjin ekzistues, të cilat mund të vështirësojnë interpretimin dhe zbatimin e tij.
- Rrezik i mosadresimit të plotë të çështjeve të reja komplekse, si administrimi i kriptoaseteve, të cilat mund të kërkojnë një kuadër më të specializuar dhe më fleksibël sesa ai ekzistues.

- Efekt i kufizuar në përmirësimin strukturor të sistemit, pasi nuk ndryshon në thelb modelin institucional të administrimit të pasurive.
- Mundësi për nevojë të ndërhyrjeve të mëtejshme në të ardhmen, duke qenë se ndryshimet

Opsioni 2 – Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri:

Ky opsion konsiston në hartimin dhe miratimin e një ligji të ri për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, i cili do të zëvendësojë kuadrin ekzistues ligjor dhe do të adresojë në mënyrë të plotë problematikat e identifikuar gjatë zbatimit të tij. Ligji i ri synon të qartësojë kompetencat institucionale, të përmirësojë procedurat e administrimit dhe disponimit të pasurive, të forcojë mekanizmat e koordinimit ndërinstytucional, si dhe të krijojë baza më të forta për ripërdorimin social dhe institucional të pasurive të konfiskuara. Gjithashtu, ai do të mundësojë harmonizimin e mëtejshëm me standardet dhe praktikën ndërkombëtare në këtë fushë, duke garantuar një sistem më të integruar, transparent dhe efektiv të administrimit të këtyre pasurive.

Avantazhet

Ky opsion ofron zgjidhjen më të plotë dhe afatgjatë për problematikat e identifikuar, pasi adreson shkaqet e tyre në nivel ligjor dhe institucional. Përmes krijimit të një kuadri të ri ligjor, sigurohet qartësi më e madhe në ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësi ndërmjet institucioneve, reduktohen paqartësitë procedurale dhe forcohet siguria juridike në procesin e administrimit të pasurive. Njëkohësisht, krijohen mekanizma më efektivë për ruajtjen e vlerës ekonomike të pasurive, rritjen e të ardhurave publike, përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe zgjerimin e mundësive për ripërdorimin e tyre në interes publik. Përfitimet e këtij opsioni pritet të jenë të qëndrueshme në kohë dhe të kontribuojnë në rritjen e efektivitetit të luftës kundër kriminalitetit dhe korrupsionit.

Disavantazhet

Zbatimi i këtij opsioni kërkon investime fillestare financiare, administrative dhe njerëzore për hartimin e legjislacionit të ri, përgatitjen e akteve nënligjore, përshtatjen e procedurave të brendshme dhe trajnimin e institucioneve përgjegjëse. Gjithashtu, procesi i miratimit dhe implementimit të ligjit mund të kërkojë kohë më të gjatë krahasuar me masat administrative, ndërsa gjatë periudhës së tranzicionit mund të lindin sfida që lidhen me përshtatjen e praktikave ekzistuese me rregullat e reja. Megjithatë, këto kosto dhe sfida konsiderohen kryesisht afatshkurtra dhe kompensohen nga përfitimet afatgjata që sjell krijimi i një sistemi më efikas, transparent dhe funksional.

Opsioni 3 – Qasje jo rregullatore:

Ky opsion konsiston në adresimin e problematikave të identifikuar përmes masave administrative, organizative dhe institucionale, pa ndërhyrë në kuadrin ligjor ekzistues. Në këtë kuadër mund të ndërmerren:

- Hartimi dhe miratimi i udhëzimeve, procedurave standarde të punës dhe akteve të brendshme administrative për unifikimin e praktikave institucionale;
- Rritja e koordinimit ndërinstytucional ndërmjet AAPSK-së, organeve të hetimit, prokurorisë, gjykatave dhe institucioneve të tjera të përfshira në procesin e sekuestrimit, konfiskimit dhe administrimit të pasurive;

- Zhvillimi i trajnimeve dhe programeve të ngritjes së kapaciteteve për stafin e institucioneve përgjegjëse;
- Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit, raportimit dhe shkëmbimit të informacionit;
- Përdorimi më efektiv i burimeve ekzistuese njerëzore, financiare dhe teknologjike;
- Hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe protokolleve operative ndërmjet institucioneve kompetente.

Avantazhet

Ky opsion paraqet avantazhin e zbatimit të shpejtë dhe fleksibël të masave përmirësuese, pasi nuk kërkon ndjekjen e procedurave të gjata ligjvënëse dhe miratimin e ndryshimeve në legjislacionin primar. Masat administrative dhe organizative mund të ndërmerren brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore, duke mundësuar adresimin e menjëhershëm të disa problematikave praktike që hasen në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Gjithashtu, ky opsion kërkon kosto më të ulëta financiare dhe administrative krahasuar me një reformë ligjore, pasi mbështetet kryesisht në strukturat, procedurat dhe burimet ekzistuese institucionale. Përmes përmirësimit të koordinimit ndërinstytucional, standardizimit të praktikave të punës dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit, mund të arrihen përmirësime në efikasitetin operacional dhe në cilësinë e administrimit të pasurive pa krijuar detyrime të reja ligjore për institucionet e përfshira.

Disavantazhet

Megjithatë, ky opsion ka kufizime të konsiderueshme në raport me problematikat e identifikuar. Shumë prej tyre burojnë nga mangësi ose paqartësi të vetë kuadrin ligjor dhe, për rrjedhojë, nuk mund të zgjidhen në mënyrë të plotë vetëm përmes masave administrative. Udhëzimet, protokollet dhe marrëveshjet ndërinstytucionale nuk kanë të njëjtën forcë detyruese si dispozitat ligjore dhe mund të zbatohen në mënyrë jo të njëtrajtshme nga institucionet e ndryshme. Për më tepër, ky opsion nuk mundëson krijimin e kompetencave të reja, rregullimin e boshllëqeve ligjore apo harmonizimin e plotë me standardet dhe praktikat ndërkombëtare në fushën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Si rezultat, ndikimi i tij pritet të jetë i kufizuar dhe afatshkurtër, ndërsa problematikat strukturore mund të vazhdojnë të mbeten të pazgjidhura.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Opsioni 1 prek një gamë të gjerë grupesh interesi, përfshirë institucionet e sistemit të drejtësisë (prokuroritë dhe gjykatat), Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), organet e administratës shtetërore dhe vendore, subjektet private, si dhe qytetarët. Ndikimet e pritshme janë institucionale, ekonomike, financiare dhe sociale, me një efekt neto përgjithësisht pozitiv në drejtim të rritjes së efikasitetit të administrimit dhe rikuperimit të pasurive, si dhe forcimit të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

1. Ndikimet institucionale

Projektligji pritet të përmirësojë ndjeshëm funksionimin institucional përmes:

- rritjes së qartësisë së roleve ndërmjet AAPSK-së dhe organeve të drejtësisë;
- standardizimit të praktikave të ekzekutimit të vendimeve të sekuestrimit dhe konfiskimit;
- përmirësimit të koordinimit ndërinstytucional dhe shkëmbimit të informacionit;

- forcimit të kapaciteteve të brendshme të AAPSK-së për administrimin e portofolit në rritje të pasurive.

Për institucionet e drejtësisë, efekti kryesor është ulja e vonesave procedurale dhe rritja e efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve. Për AAPSK-në, ndikimi lidhet me rritjen e ngarkesës operationale, por edhe me përmirësimin e strukturimit të brendshëm dhe profesionalizimit të stafit.

2. Ndikimet ekonomike dhe sociale

Në aspektin ekonomik, projektligji rrit eficiencën në përdorimin e pasurive të sekuestruara, duke reduktuar humbjet nga zhvlerësimi i tyre dhe nga administrimi jo optimal. Përmes rritjes së qarkullimit të pasurive në ekonomi (qira, shitje, përdorim institucional), krijohet një efekt multiplikues në ekonominë publike.

Në aspektin social:

- rritet përdorimi i pasurive për qëllime publike dhe sociale;
- përmirësohet perceptimi publik mbi drejtësinë dhe konfiskimin e aseteve kriminale;
- rritet transparenca dhe besimi në institucionet zbatuese.

3. Ndikimet financiare – metodologjia e llogaritjes së kostove

3.1 Qasja metodologjike e përdorur

Për vlerësimin e kostove është përdorur një qasje “bottom-up costing” (nga poshtë-lart), e kombinuar me:

- kostim standard të pozicioneve të punës (unit cost per FTE);
- projeksion të volumit të punës (rritja e pasurive të administruara);
- analizë të të ardhurave historike të AAPSK-së (baseline revenues);
- parim të vetëfinancimit të agjencisë (cost recovery model).

Kjo metodologji është e përshtatshme për institucione që:

- gjenerojnë të ardhura vetjake;
- kanë funksion operational me ngarkesë të ndryshueshme (variable workload);
- nuk varen drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit për shpenzimet operative.

3.2 Supozimet kryesore të kostos së personelit

Për llogaritjet janë bazuar në këto supozime standarde:

- Pozicion referencë “Administrator”: pagë bruto mesatare rreth 110,000 lekë/muaj
- Pozicion “Ndihmës administrator”: pagë bruto mesatare rreth 85,000 lekë/muaj
- Kontribute shoqërore dhe shëndetësore: rreth 16.7% – 17% mbi pagën bruto

- 13 paga vjetore të konsideruara për efekt total vjetor (12 muaj + shpërblime mesatare të konsoliduara në strukturë)

3.3 Përlllogaritja e kostos së personelit

Shtimi i kapaciteteve:

- 5 Administratorë
- 5 Ndhmës administratorë

Kosto vjetore e pagave (paga + kontribute):

- Administratorë: $\sim 110,000 \text{ lekë} \times 12 \text{ muaj} \times 5 = 6,600,000 \text{ lekë}$
- Ndhmës administratorë: $\sim 85,000 \text{ lekë} \times 12 \text{ muaj} \times 5 = 5,100,000 \text{ lekë}$
- Kontribute mesatare ($\sim 17\%$): $\sim 1,955,000 \text{ lekë}$

Totali i kostos së personelit: $\sim 17,155,000 \text{ lekë/vit}$

3.4 Kostot operative

Përveç pagave, struktura e zgjeruar kërkon:

- shpenzime administrative (zyra, pajisje, IT);
- shpenzime transporti dhe logjistike;
- mirëmbajtje sistemesh dhe administrim të pasurive.

Këto vlerësohen në bazë të:

- kosto mesatare për një punonjës administrativ ($\sim 4.5 - 5 \text{ mln lekë/vit}$ strukturore operative të agreguara)

Kosto operative totale: $\sim 47,775,000 \text{ lekë/vit}$

3.5 Kosto totale dhe balanca financiare

- Kosto totale vjetore: **64,930,000 lekë**
- Të ardhura të pritshme AAPSK: **85,200,000 lekë**

Tepricë neto: +20,270,000 lekë

Kjo tregon se:

- sistemi është **financiarisht i vetëqëndrueshëm**
- nuk krijon barrë për buxhetin e shtetit
- madje gjeneron **tepricë pozitive fiskale**

4. Ndikimi sipas grupeve të prekura

4.1 Institucionet e drejtësisë

- rritje e efektivitetit të ekzekutimit të vendimeve
- ulje e vonesave procedurale
- përmirësim i bashkëpunimit me AAPSK

4.2 AAPSK

- rritje e kapaciteteve operative
- nevojë për staf shtesë dhe profesionalizim
- përmirësim i eficiencës së administrimit të portofolit të pasurive

4.3 Institucionet vendore

- përfitim nga përdorimi i pasurive në territor
- rritje e bashkëpunimit për ripërdorim social

4.4 Subjektet private

- rritje e sigurisë juridike në proceset e sekuestrimit
- transparencë më e madhe procedurale
- ndikim indirekt përmes formalizimit të praktikave

4.5 Qytetarët / komuniteti

- rritje e përfitimeve sociale nga pasuritë e konfiskuara
- përdorim i pasurive për institucione publike dhe OJF
- rritje e besimit në shtetin e së drejtës

5. Ndikimi mbi kategoritë e reja të pasurive (monedhat virtuale)

Administrimi i aseteve digjitale përbën një fushë të re rregullatore. Aktualisht:

- është në proces hartimi një ligj i veçantë për monedhat virtuale;
- pritet të përcaktohen procedurat e sekuestrimit, ruajtjes dhe likuidimit të tyre;
- do të plotësohet me akte nënligjore për implementimin teknik.

Kjo shmanë krijimin e boshllëqeve operative në fazën tranzitore.

6. Përfundim

Opsioni i ndryshimit të ligjit ekzistues:

- rrit efikasitetin administrativ;

- përmirëson transparencën;
- forcon koordinimin institucional;
- gjeneron të ardhura neto pozitive;
- nuk krijon barrë për buxhetin e shtetit.

Megjithatë, mbetet një ndërhyrje e pjesshme, pasi disa problematika strukturore dhe teknologjike nuk adresohen plotësisht vetëm përmes ndryshimeve në ligjin ekzistues.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e optionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar është opsioni 1- kryerja e disa ndryshimeve në ligjin aktual në **ligji nr. 34/2019** fuqi. Ky option është vlerësuar si më i përshtatshmi, pasi ofron një zgjidhje të balancuar ndërmjet nevojës për përmirësime ligjore dhe kufizimeve të burimeve administrative dhe buxhetore. Ky option mundëson adresimin e problematikave kryesore të identifikuara, pa krijuar ngarkesa të mëdha financiare apo institucionale, duke garantuar një zbatim më të shpejtë dhe më efektiv. Risitë kryesore të projektligjit përfshijnë:

- Përmirësimin dhe qartësimin e dispozitave ekzistuese ligjore;
- Përcaktimin më të qartë të kompetencave dhe përgjegjësi të institucioneve të përfshira;
- Forcimin e mekanizmave të administrimit, monitorimit dhe kontrollit;
- Lehtësimin e procedurave administrative dhe eliminimin e paqartësive të hasura në praktikë;
- Rritjen e efektivitetit dhe transparencës në zbatimin e legjislacionit;
- Përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, sipas rastit.

Krahasuar me optionet e tjera të shqyrtuara, ky option vlerësohet si më efektiv dhe proporcional, pasi adreson shkaqet e problemit në nivel ligjor dhe krijon bazën e nevojshme për përmirësimin e funksionimit të sistemit në tërësi.

Kostoja e përlogaritur në total e optionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti <u>1</u>	Viti <u>2</u>	Viti <u>3</u>
0	0	0

KONSULTIMI

P/ligji është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-akte pranë Ministrive të linjës, konkretisht Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrit të Shtetit të Pushteti Vendor dhe Agjencisë së Prokurimit Publik. Sugjerimet e ministrive janë reflektuar. Aktualisht P/Ligji është në fazën e bashkërendimit.

Gjithashtu P/ligji është hedhur për konsultim publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në datën 19.12.2025 dhe ka qëndruar deri në datën 21.01.2026. P/ligji ka pasur 513 lexime dhe nuk ka pasur komente.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Zbatimi i ndryshimeve ligjore do të sigurohet nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e tjera përgjegjëse sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

Në kuadër të zbatimit të projektligjit, institucionet përgjegjëse do të kenë këto detyra kryesore:

- **AAPSK** do të jetë institucioni përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, përfshirë pasuritë e llojit monedha virtuale, mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të pasurive, zbatimin e procedurave të administrimit, disponimit dhe raportimit periodik.
- **Ministria e Punëve të Brendshme** do të koordinojë procesin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore, si dhe monitorimin e përgjithshëm të zbatimit të politikave në fushën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.
- **Prokuroria dhe Gjykatat** do të sigurojnë komunikimin dhe shkëmbimin në kohë të informacionit mbi masat e sekuestrimit dhe konfiskimit, si dhe ekzekutimin e vendimeve përkatëse.
- **Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organet administrative kompetente** do të bashkëpunojnë me AAPSK për identifikimin, transferimin dhe administrimin e pasurive që kalojnë në administrim ose pronësi të shtetit.
- **Institucionet financiare dhe subjektet e licencuara për shërbime të aseteve virtuale**, sipas legjislacionit në fuqi, do të bashkëpunojnë me AAPSK dhe organet ligjzbatuese për ruajtjen, transferimin dhe administrimin e monedhave virtuale të sekuestruara ose të konfiskuara.

Projektligji parashikon gjithashtu përmirësimin e bashkëveprimit dhe bashkërendimit ndërinstitucional ndërmjet organeve të drejtësisë, organeve administrative dhe njësiteve të vetëqeverisjes vendore në të gjitha fazat e procesit të sekuestrimit, konfiskimit dhe administrimit të pasurive, me qëllim rritjen e efikasitetit, shmangien e mbivendosjeve të kompetencave dhe eliminimin e boshllëqeve procedurale.

Një nga problematikat kryesore që adreson projektligji është administrimi i pasurive të llojit monedha virtuale. Për shkak të natyrës teknologjike të këtyre aseteve, mungesës së praktikave të konsoliduara administrative dhe nevojës për ruajtjen e vlerës së tyre ekonomike, do të hartohen akte nënligjore të posaçme që do të përcaktojnë procedurat e identifikimit, ruajtjes, transferimit, administrimit dhe disponimit të tyre.

Paralelisht me hyrjen në fuqi të projektligjit, do të ndërmerren masa mbështetëse për garantimin e zbatimit efektiv të tij, si:

- forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale përmes trajnimit të stafit të AAPSK dhe institucioneve të përfshira në administrimin e pasurive;
- trajnime specifike për administrimin e kryptoaseteve, menaxhimin financiar të pasurive të konfiskuara dhe zbatimin e procedurave të reja ligjore;
- zhvillimi i sistemeve digjitale për menaxhimin dhe monitorimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;
- vendosja e mekanizmave të qartë të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet AAPSK, Prokurorisë, Gjykatave, organeve të pushtetit vendor dhe institucioneve financiare;
- krijimi dhe operacionalizimi i fondit të posaçëm për administrimin e të ardhurave që rrjedhin nga konfiskimi i ndërtimeve pa leje, duke përcaktuar rregullat e menaxhimit, përdorimit dhe raportimit të tij, si dhe duke garantuar transparencën në administrimin e fondeve.

Gjatë zbatimit të projektligjit mund të paraqiten sfida të lidhura me mungesën e ekspertizës teknike për administrimin e monedhave virtuale, koordinimin ndërinstytucional, si dhe përshtatjen e sistemeve administrative dhe financiare me procedurat e reja. Për adresimin e tyre do të përdoren masa organizative, trajnuese dhe teknologjike, si dhe do të hartohen udhëzime të detajuara për institucionet përgjegjëse.

Monitorimi i zbatimit

Monitorimi i zbatimit të ligjit do të realizohet nga AAPSK dhe Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse.

Për këtë qëllim do të zbatohen mekanizma monitorimi dhe raportimi periodik, duke përfshirë:

- raportime tremujore dhe vjetore nga AAPSK mbi administrimin dhe disponimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;
- raportime mbi administrimin e pasurive të llojit monedha virtuale dhe ruajtjen e vlerës së tyre;
- raportime mbi funksionimin e fondit të posaçëm dhe përdorimin e të ardhurave të gjeneruara;
- monitorimin e shkallës së bashkëpunimit ndërinstytucional dhe respektimit të afateve procedurale;
- auditime të brendshme dhe të jashtme mbi zbatimin e ligjit dhe efektivitetin e procedurave të administrimit.

Treguesit e performancës

Arritja e objektivave të projektligjit do të matet përmes treguesve të mëposhtëm:

1. Përqindja e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet administrative dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore të regjistruara në sistemin e AAPSK.
2. Numri i rasteve të trajtuara sipas kuadrit të unifikuar ligjor dhe ulja e rasteve të trajtimit jashtë procedurave standarde.
3. Numri i rasteve të monedhave virtuale të sekuestruara dhe të administruara sipas procedurave të reja dhe përqindja e rasteve ku është garantuar ruajtja e vlerës së tyre.
4. Krijimi dhe funksionaliteti i fondit të posaçëm brenda afateve të përcaktuara, vlera e të ardhurave të kanalizuar në fond dhe numri i projekteve publike të financuara prej tij.
5. Numri i punonjësve të trajnuar në AAPSK dhe institucionet e tjera përgjegjëse.
6. Vlera totale e pasurive të administruara dhe të disponuara përmes shitjes, dhënies me qira ose enfiteozës.
7. Rritja e të ardhurave të gjeneruara nga administrimi i pasurive dhe ulja e kostove të mbajtjes së tyre.
8. Numri i marrëveshjeve, procedurave dhe mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstytucional të vendosur dhe funksionalë.
9. Niveli i përdorimit të sistemeve digjitale të menaxhimit dhe monitorimit të pasurive.
10. Përmirësimi i efikasitetit të procesit të administrimit të pasurive, i matur përmes kohës së nevojshme për marrjen në administrim dhe disponimin e tyre.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93	64.93
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës	64.93	61.68	59.07	56.49	53.25	51.29	48.70	46.10	44.15	42.21
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi										
Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										

Përfitimet për biznesin – një herë										
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale	85.20	85.20	85.20	85.20	85.20	85.20	85.20	85.20	85.20	85.20
Përfitimi i zbritur= Përfitimi në total x faktori zbritës	85.20	80.94	77.53	74.12	69.86	67.31	63.90	60.49	57.94	55.38
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	692.60									
Vlera prezente aktuale e kostos në total	537.90									
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	154.70									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	537.90	537.90	537.90
Opsioni 2	0	0	0

MINISTËR

Besfort Lamallari